Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PËR PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT-Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson U.D. i Menaxhei-ja, Gëzim Ademaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

"UROPRINTY", nga Komuna e Prishtinës,të cilën e përfaqëson z. VALON ZYBERI , ne cilësinë e të autorizuarit te kompanisë nr. te Rexh. Biznesit 810912718 (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

FURNIZIMI DHE MONTIMI ME PAISJE TE INFORMATIKËS PËR REALIZIMIN E MESIMIT SIPAS MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E MESIMIT NE KOHË PANDEMIJE PËR VITIN 20-21

Nr. I prokurimit	**633-20-7039-1-2-1/C430**
Nr. I brendshëm	**633 / 020 / 108 / 121**

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë:

FURNIZIMI DHE MONTIMI ME PAISJE TE INFORMATIKËS PËR REALIZIMIN E MESIMIT SIPAS MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E MESIMIT NE KOHË PANDEMIJE PËR VITIN 20-21 FURNIZIMI ME PAISJE TE TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 10 DITË pas porosisë se Autoritetit Kontraktues. nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe të lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë Drejtorati Për Arsim dhe kulturë - Istog

2.3 Inkotermi1 i zbatueshëm do të jetët *DDP*

Neni 3 Origjina

3.1Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjën e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet total I kësajë kontrate për pagesë është: **43.180,00 €**

"Katerdhjetetremijëenjëçindetetëdhjetëzerozeroeuro"

42. Oferta financijare e furnitorit e datës **10.11.2020** është pjesë përberese e kësajë kontrate dhe bazë për pagesën e furnitorit.

4.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kjo marrëveshje e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare;

Plani per menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e

komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kurdo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe **fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.**

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: **Komuna e Istogut**		*Për Kontraktorin:* **"EURO PRINTY" SHPK**	
Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Valon Zabeli***
Pozita:	***U.D. I Menaxheri-t të Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r i2***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	16. 12. 2020	***Data:***	16. 12. 2020
Vula		***Vula***	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	***Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.***
	2.2	***Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe***
Siguria e ekzekutimit	8.1	***Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 1 muaj me gjate se perfundimi i kontrates.***
Cilësia e furnizimeve	16.2	***Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë.*** ***Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.***
Dorëzimi	19.3	***Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues***
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	***Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.***
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	***Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.***

KOMUNA E ISTOGUT					
FURNIZIMI DHE MONTIMI ME PAISJE TE INFORMATIKES PER REALIZIMIN E MESIMIT SIPAS MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E MESIMIT NE KUSHTE PANDEMIE COVID 19 PER VITIN 20-21					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i pajisjeve (emri i artikullit)	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
2	Mbajtse per montimin e TV në mureë dhe montimi i TV	copë	118	10.0 €	1,180.0 €
3	Televizor 58" Led Uhd 4K Smart Tv Android Madhësia e ekranit 58 - 148 cm Tipi i panelit LED Tiparet e fotografisë HDR, Dolby Vision HDR, UHD Upscaler Rezulucioni Ultra HD 4K - 3840 x 2160p Indeksi i përformancës së fotogfarisë 1900 TPQ Thellësia e ngjyrës 8bit+FRC Raporti i kontrastit 4000 : 1 Këndi i shikimit (Horiz / Vert) 178 / 178 Smart TV Yes Sistemi Operativ Android Tiparet e smart TVs Quad Core, Play Store, Shfletues, Youtube, HBB TV, Screen Mirroring Wifi Yes Bluetooth Yes Tiparet e zërimit Audio Output Power (RMS) 20W, Dolby Audio™, DTS™ Decoder, Equalizer 5 band, Ger (D) + Nicam Stereo	copë	118	350.0 €	41,300.0 €
6	HDMI Kabull 10m	copë	100	7.0 €	700.0 €
	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT				43,180.00 €

